



ELEKTROMAGNETIZMI I ZBATUAR

Kodi i lëndës	Tipologjia e lëndës	Lloji i lëndës	Viti akademik	Semestri
V1S1	A	E detyrueshme	2018-2019	I

Departamenti i Automatikës	 (firma e titullarit të lëndës)
Programi i studimit: Master i shkencave, profili Automatizim i industrisë	
Titullari i lëndës: Myrteza Braneshi, Profesor i asociuar	
Pedagogë të lëndës: Lindita Dhamo, Doktor i shkencave	

Aktiviteti mësimor	Leksion	Seminar	Laborator	Detyra	Total
Kreditet (ECTS)	4	2	0	0	6
Orë në auditor	40	24	0	0	64
Orë jashtë auditorit	60	26	0	0	86
Orë gjithsej	100	50	0	0	150

Njohuri paraprake

Studenti duhet të ketë njohuri matematike të mira, kryesisht të algjibrës vektoriale, të njehsimit diferencial dhe integral dhe të integraleve vijëpërkulura dhe sipërfaqësore si dhe të analizës komplekse. Gjithashtu studentit duhet të jetë në gjendje të abstragojë në lidhje me kuptimet e fushave elektrike dhe magnetike, të marra në lëndën e fizikës dhe të Teorisë së fushës elektromagnetike.

Objektivat e lëndës

Lënda ka për qëllim të thellojë dhe të përforcojë njohuritë në lidhje me dukuritë elektromagnetike dhe të rrisë shkallën e aftësisë së studentit për t'u orientuar në problemet e ndryshme që ndeshen në këtë fushë.

Lënda ka për qëllim të rrisë shkallën e abstragimit në fushën e teorisë elektromagnetike që studentit të krijojë një bazë të qëndrueshme për të kuptuar dhe me pas të përdorë modelet që përdoren në këtë fushë.

Lënda ka për qëllim dhënien dhe përvetësimin e metodave analitike kryesore si dhe zbatimin e tyre në situata të ndryshme. Gjithashtu studentët do të marrin njohuritë bazë për funksionet speciale më të përdorshëm që ndeshen në metodat analitike.

Njohuritë dhe aftësitë që përftohen nga përvetësimi i lëndës

Lënda zhvillohet në semestrin e parë, të vitit të parë, në 12 javë. Me fitimin e krediteve të saj studentit duhet të jetë i aftë:

- Të njohë në një nivel më të lartë dhe të përdorë modelet e ndryshme të fushës elektrike.
- Të njohë në një nivel më të lartë dhe të përdorë modelet e ndryshme të fushës magnetike.
- Të njohë dhe të përdorë modelet për llogaritjen e dukurive sipërfaqësore.
- Të njohë dhe të përvetësojë metodat kryesore analitike.
- Të përvetësojë disa nga zbatimet e teorisë së fushës elektromagnetike për zgjidhjen e problemeve me interes praktik.



Kuptimet themelore

Kuptimet dhe termat bazë mbi të cilën ndërtohet lënda.

Kuptimi 1: Potencialet në fushën elektromagnetike

Kuptimi 2: Metodatat analitike për llogaritjen e fushës elektromagnetike

Leksione:	4 kredite x 10 orë	40 orë
Njohuritë themelore të fushës elektrostatiske. Potenciali i shtresës së njëfishtë dhe të dyfishtë. Teorema e Ernshtout. Kushtet kufitare. Teoremat e përgjithshme. Teoremat e Gausit dhe e Stoksit. Teorema dhe funksioni i Grintit.		4 orë
Teorema e unicitetit në fushën elektrostatiske. Kapacitorët. Energjia dhe forcat në fushën elektrostatiske. Koeficientët potencialë dhe kapacitivë, modelet e llogaritjes së tyre. Ekuacionet e Puasonit dhe të Laplasit. Teorema e reciprocitetit e Grintit. Zbatime.		4 orë
Fusha magnetike e rrymave. Ligji i Bio-Savarit. Zbatime të tyre për llogaritjen e shpërndarjeve të ndryshme të rrymave. Llogaritja e fushës magnetike të linjave elektrike dhe të bobinave rrethore të ndryshme. Llogaritja e induktiviteti vetiak dhe reciprok për raste të thjeshta.		4 orë
Potencialet magnetike skalare dhe vektoriale. Ekuacionet e tyre dhe përdorimi për llogaritjen e fushës magnetike. Modelet për llogaritjen e fushave magnetike në praninë e trupave të magnetizuar.		4 orë
Metoda e ndarjes së ndryshoreve në dy përmasa. Harmonikat rrethore. Metoda e përfytyrimeve të pasqyruara në cilindër dhe plan. Metoda e përfytyrimeve të pasqyruara në tri përmasa. rasti me numër të pafundëm pasqyrimesh. Zbatime.		4 orë
Pasqyrimet konforme për zgjidhjen e fushave dypërmasore. Zbatime të tyre. Transformimi i Shvarc-Kristofelit. poligonet me një dy dhe tre kënde.		4 orë
Metoda e ndarjes së ndryshoreve në koordinata cilindrike. Ekuacioni i Beselit. Funksionet e Beselit.		4 orë
Metoda e ndarjes së ndryshoreve në koordinata sferike. Ekuacioni i Lezhandrit. Polinomet dhe funksionet e Lezhandrit.		4 orë
Ligji i induksionit magnetik i Faradeit. Modelet për llogaritjen e rrymave fuko. Llogaritja e shpërndarjes së rrymës në përcjellësat drejtkëndorë. Efekti i shtytjes së rrymës në makinat elektrike. Llogaritja e rrezistencës së përcjellësave me prerje tërthore drejtkëndore.		4 orë
Dukuritë sipërfaqësore në përcjellësat rrethorë. Llogaritja e shpërndarjes së rrymës dhe e fushës në këto përcjellësa.		4 orë



Seminare:	2 kredite x 12 orë	24orë
Fusha elektrostатike.		2 orë
Koeficientët potencialë dhe kapacitivë		2 orë
Teorema e reciprocitetit e Grint.		2 orë
Zbatime të ligjit të Bio-Savarit.		2 orë
Përdorimi i potencialeve për llogaritjen e fushës magnetike.		2 orë
Metoda e përfyryrimeve të pasqyruara në plan dhe në hapësirë.		2 orë
Metoda e ndarjes së ndryshoreve në plan.		2 orë
Metoda e pasqyryrimeve konforme.		2 orë
Metoda e ndarjes së ndryshoreve në koordinata cilindrike.		2 orë
Metoda e ndarjes së ndryshoreve në koordinata sferike.		2 orë
Llogaritja e rrymave fuko në përcjellësat drejtkëndorë.		2 orë
Llogaritja e rrymave fuko në përcjellësat rrethorë.		2 orë

Parakushte për hyrjen në provimin e lëndës
Lënda nuk ndërvoaret nga asnjë lëndë; frekuentimi i leksioneve dhe i seminareve në masën 75 %.

Provimi i lëndës	3 orë
<i>Lënda jepet provim me shkrim, në sesionin përkatës të provimeve. Teza e provimit përmban 65% pyetje teorike, nga tematika e leksioneve dhe 35% ushtrime, nga tematika e seminareve dhe shembujt e trajtuar në leksionet.</i>	

Vlerësimi për lëndën
<i>Lënda vlerësohet 100 % sipas provimit përfundimtar.</i>

Literatura e rekomanduar për lëndën		
Smythe W.	<i>Static and dynamic electricity</i>	Taylor & Francis, 1989

Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës
<i>Nuk ka vërejtje.</i>



PËRPUNIMI NUMERIK I SINJALEVE TË MATURA

Kodi i lëndës	Tipologjia e lëndës	Lloji i lëndës	Viti akademik	Semestri
V1S3	B	E detyrueshme	2018-2019	Sem. I

Departamenti i Automatikës	(firma e titullarit të lëndës)
Programi i studimit: Master Shkencor në Inxhinieri Elektrike, Automatizim i Industrisë	
Titullari i lëndës: Genci Sharko, Prof. As., genci.sharko@fie.upt.al	
Pedagogë të Lëndës: Genci Sharko, Prof. As., genci.sharko@fie.upt.al	

Aktiviteti mësimor	Leksion	Seminar	Laborator	Praktikë	Detyra	Total
Kreditet (ECTS)	3	2	0.5	0	0.5	6.0
Orë në auditor	30	24	10	0	2.5	66.5
Orë jashtë auditorit	45	26	2.5	0	10	83.5
Orë gjithsej	75	50	12.5	0	12.5	150

Njohuri paraprake

Studenti duhet të ketë fituar njohuritë bazë në lëndët e fizikës, matematikës, matjes dhe elektroteknikës.

Objektivat e lëndës

Kursi ka si objektivi të japë studentëve kompetencat bazë për përpunimin numerik të sinjalit të aplikuar në fushën e matjeve elektrike dhe thellimin e njohurive në metodologjinë e matjeve që karakterizojnë komponentet e sistemeve elektrike. Jepen kështu problemet teorike në lidhje me kampionimin e sinjalit dhe ilustrohen arkitekturat kryesore të instrumentave matës të bazuar në teknikat numerike.

Njohuritë dhe aftësitë që përftoheshin për vetësimin e lëndës

Lëndazhvilohet në semestrin e dytë, në vitin e dytë, në 12 javë. Mësimi kreditiv i studentit duhet të jetë i aftë:

- Përdorimin e sensoreve për përpunimin numerik të sinjaleve
- Metodën për matjen e madhësive jo elektrike me metoda elektrike
- Arkitekturat kryesore të instrumentave të matjes bazuar në AO
- Arkitekturat kryesore të instrumentave të matjes bazuar në teknikat numerike

Konceptet themelore

Konceptet dhe termat bazë mbi të cilën ndërtohet lënda.

Koncept 1

Koncept 2 ...



Leksione:	3 kreditex 10orë	30orë
Aspektet te sensoreve per perpunimit numerik te sinjaleve		2.5 orë
Metodat per matjen e madhesive si temperatura, zhvendosja.		2.5 orë
Metodat per matjen e madhesive si presioni, forca.		2.5 orë
Akitekturat kryesore te instrumentave te matjes bazuar ne AO		2.5 orë
Akitekturat kryesore te instrumentave te matjes bazuar ne teknikat numerike		2.5 orë
Akitekturat kryesore te instrumentave te matjes bazuar ne teknikat numerike		2.5 orë
Avancime ne konceptet e dhenesave te rrymes dhe te tensionit		2.5 orë
Problemet qe lindin ne matjen e sinjaleve te deformuar		2.5 orë
Shderuesat e tensionit dhe rrymes me efekt holli		2.5 orë
Avancime ne metodogjine e matjeve per testet ne shderuesat ADC		2.5 orë
Vleresimi i jolineariteve statike te ADC		2.5 orë
Vleresimi i jolineariteve dinamike te ADC		2.5 orë

Seminare:	2kredite x 12orë	24orë
Ushtrime ne sensoret e sinjaleve per matje temperature		2 orë
Ushtrime ne sensoret e sinjaleve per matje temperature		2 orë
Ushtrime ne sensoret e sinjaleve per matje deformimi		2 orë
Ushtrime ne perpunimit numerik te sinjalit periodike		2 orë
Ushtrime ne sensoret e sinjaleve per matje sforcimi		2 orë
Kontroll me shkrim		2 orë
Ushtrime ne arkitekturat kryesore te instrumentave te matjes me AO		2 orë
Ushtrime ne arkitekturat kryesore te instrumentave te matjes me AO		2 orë
Ushtrime ne dhenesat e te rrymes me sensor holli		2 orë
Ushtrime ne dhenesat trasformatorike me sensir holli		2 orë
Ushtrime ne Testimet e ADC, ofseti dhe perfitimi		2 orë
Ushtrime ne Testimet e ADC, jolineariteti		2 orë

Laboratore:	0.5kredite x 20orë	10 orë
Ndertime skeme per matje e temperatures me termocifte		2 orë
Ndertime skeme per matje e temperatures me termorezistenca		2 orë
Amplifikimi, mbledhja dhe diferenca e sinjaleve me AO		2 orë
Amplifikimi, shumezimi i sinjaleve me AO		2 orë
Amplifikimi, ndertimi i filtrave te sinjaleve me AO		2 orë

Punët e laboratorit zhvillohen në javën e 2-të deri në javën e 10-të të semestrit të parë. Punët e laboratorit zhvillohen në bazë grupi me 3 deri 4 studentë. Realizimi dhe dorëzimi i relacionit për punët e laboratorit bëhet në javën e 11. Laboratoret janë parakusht për lejimin në provim.

Detyrëkursi:	2.5kreditex 5 orë	2.5 ore
Nuk ka		



Kontrollet gjatë semestrit të zhvillimit të lëndës

Lënda kontrollohet me një provim ndërmjetes me shkrim që zhvillohet në javën e 6-të, ose të 7-të

Parakushte përhyrjennë provimin e lëndës

Lënda nuk është ndërruar:

Frekuentimi i seminareve në masën 75 %; frekuentimi i laboratoreve në masën 100 %

Provim i lëndës

4 orë

Lënda jepet provim me shkrim dhe/ose me gojë, në sesionin përkatës të provimeve.

Vlerësimi për lëndën

Lënda vlerësohet 60% sipas provimit përfundimtar dhe 20% sipas rezultateve të kontrollit ndërmjetes dhe 20% sipas laboratoreve

Literatura bazë për lëndën

GENCI SHARKO	Materiale të shkruara për leksionet	2012
JACOB FRADEN	Handbook of modern sensors, physics, designs, and applications	2006

Literatura e rekomanduar për lëndën

ANALOG DEVICE	Practical design techniques for sensor signal conditioning	2000
---------------	--	------

Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës

Hapësira ku pedagogu parashtron mendime, rekomandime, vërejtje, kufizime, rezerva që lidhen me zhvillimin e lëndës në fjalë gjatë vitit akademik, nëse ka.



DINAMIKA E MAKINAVE ELEKTRIKE

Kodi i lëndës	Tipologjia e lëndës	Lloji i lëndës	Viti akademik	Semestri
	B	E detyrueshme	2018-2019	Sem. I

Departamenti i Automatikës	
Programi i studimit: Master Shkencor Automatizim Industrie	
Titullari i lëndës: Astrit Bardhi, Prof. As, asibardhi@gmail.com	
Pedagogë të Lëndës: Astrit Bardhi, Prof. As, asibardhi@gmail.com	

Aktiviteti mësimor	Leksion	Seminar	Laborator	Praktikë	Detyra	Total
Kreditet (ECTS)	4	1.5	0.5	0		6
Orë në auditor	40	18	10	0		68
Orë jashtë auditorit	60	19.5	2.5			82
Orë gjithsej	100	37.5	12.5	0		150

Njohuri paraprake

Studenti duhet të ketë fituar njohuritë bazë të fituara në lëndët e fizikës, matematikës, elektroteknikës, të mekanikës të zbatuar si dhe makinave elektrike të zhvilluar në ciklin e parë të studimeve (në regjime simetrike). Të ketë njohuritë bazë të fituara në lëndën e elektroteknikës mbi llogaritjen e procesit kalimtar në qarqet elektrike. Gjithashtu studentin duhet të ketë fituar njohuri bazë mbi përdorimin e softëve mbi zgjidhjen e ekuacioneve diferencial kryesisht MATLAB – it.

Objektivat e lëndës

Qëllimi kryesor i këtij moduli që të sigurojë për studentët e inxhinierisë elektrike njohuri të thelluara rreth sjelljes dinamike të makinave elektrike (makinës asinkrone, makinës sinkrone dhe makinave të rrymës së vazhduar). Zbatimi i njohurive dhe aftësive të të kuptuarit e të diplomuarit do të sigurojë një qasje në mënyrë rigorozë e problemeve të lidhura me fenomenet dinamike të makinave elektrike. Studentët të jenë të aftë që të ndërtojnë modelet matematike të makinave elektrike si dhe ti simulojë ato në softë të ndryshme kompjuterike kryesisht në MATLAB. Zbatimi i njohurive dhe aftësisë së kuptuarit do t'ju sigurojë studentëve të ciklit të Dytë të studimeve një qasje rigorozë me problemet që lidhen me sistemet e kontrollit të makinave elektrike si dhe ndikimi i tyre në rrjetin elektrik gjatë procesit kalimtar.

Njohuritë dhe aftësitë që përftohen nga përvetësimi i lëndës

Lënda zhvillohet në semestrin e Parë, të vitin e Parë, në 12 javë. Me fitimin e krediteve të saj studentin duhet të jetë i aftë:

- Të përdori sistemet e ndryshme koordinative për studimin e makinave elektrike.
- Të ndërtojë modelet matematike të makinave elektrike si dhe të simulojë ato në softë të ndryshme kompjuterike.
- Të kuptojë sjelljen dinamike të makinave elektrike të cilët i nënshtrohen ngacmimeve të mëdha.
- Të përzgjedhë llojin e makinave elektrike bazuar në treguesit teknik si dhe procesit teknologjik.
- Të fitojë njohuri mbi mënyrat e kontrollit të shpejtësisë së makinave elektrike me orientim fushe (FOC & DTC).



Konceptet themelore

Konceptet dhe termat bazë mbi të cilën ndërtohet lënda.

Koncept 1

Koncept 2 ...

Leksione:	4 kreditex 10 orë	40 orë
Shndërrimi elektromekanik i energjise. Përcaktimi i shprehjes së momentit elektromagnetik nga ko – energjia në një sistem linear.		4 orë
Modelet dinamike të makinave të rrymës së vazhduar me qark magnetik linear.		3 orë
Analiza e sistemeve alternative trefazore, transformimet e Park – ut, teoria bazë e fazorit hapësinor		3 orë
Kuptimi i vektorit hapësinor, shprehja e madhësive elektrike me anë të vektorit hapësinor. Gjurma e vektorit hapësinorë për regjime simetrike dhe asimetrike në sistemet trefazore.		3 orë
Sistemet kordinative ortogonale, matricat transformuese. Sistemet kordinative ortogonale që përdoren në studimin e makinave elektrike.		3 orë
Ekuacionet e përgjithshme të ekuilibrit elektrik dhe atij mekanik të makinës asinkrone me rotor në formë kafazi. Transformimi i ekuacioneve të përgjithshme të makinës asinkrone në sistemin kordinativ orthogonal i cili rrotullohet me shpejtësi të çfardoshme.		3 orë
Modeli matematik i rendit të V i makinës asinkrone. Reduktimi Modeleve Matematike të Makinave Asinkrone në sistemin kordinativ ortogonal arbitrar. Modeli i rendit te I-re, II-te, III-te.		4 orë
Punimi në regjime asimetrike i makinës asinkrone. Gjeneratorët asinkronë. Kushtet e vetësitimit të gjeneratorëve asinkronë. Punimi i gjeneratorëve asinkron të izoluar dhe të lidhur në një sistem me fuqi të pafundme. Karakteristikat e gjeneratorit asinkron		3 orë
Modeli matematik i makinës sinkrone në kordinata a, b, c. Modeli matematik i makinës sinkrone në sistemin kordinativ Odq.		4 orë
Reduktimi Modelit Matematik të Makinës Sinkrone		3 orë
Lëkundjet dhe qëndrueshmëria dinamike e makinës sinkrone.		4 orë
Punimi në regjimin asimetrik i makinës sinkrone.		3 orë

Seminare:	1.5 kredite x 14orë	21orë
Llogaritja e energjisë dhe ko-energjisë në një sistem elektro-mekanik		2 orë
Ndërtimi i modelit matematike të makinave të rrymës së vazhduar. Simulimi në Matlab i MRV		1 orë
Përcaktimi i vektorit hapësinor i madhësive elektrike në një system trefazor.		2 orë
Matricat e transformimit. Paraqitja e madhësive elektrike në sistemet e ndryshme kordinative		1 orë



Ndërtimi i modelit matematik të makinës asinkrone dhe simulimit të tij në Matlab (Mod. V).	2 orë
Ndërtimi i modelit matematik të makinës asinkrone dhe simulimit të tij në Matlab (Mod. III, I).	1 orë
Punimi i motorit asinkron në regjim asimetrik.	2 orë
Ndërtimi i modelit matematik të makinës sinkrone dhe simulimit të tij në Matlab.	1 orë
Llogaritja e këndit të ngarkesës për ngacmime të mëdha në Makinën Sinkrone.	2 orë
Qendrueshmëria dinamike e Makinës Sinkrone	1 orë
Llogaritja e rrymave në Makinën Sinkrone gjatë punimit të tij në regjim asimetrik.	2 orë
Llogaritja e rrymave në Makinën Sinkrone gjatë punimit të tij në regjim asimetrik.	1 orë

Laboratore:	0.5 kredite x 20orë	10 orë
Studimi eksperimental i motorit asinkron në regjim asimetrik		3 orë
Studimi eksperimental i gjeneratorit asinkron trefazor.		3 orë
Përcaktimi eksperimental i parametrave të makinës sinkrone		3 orë
<i>Punët e laboratorit zhvillohen në javën e 5-të, 8 – të dhe 10 - të të semestrit të Parë, të vitit të Parë. Punët e laboratorit zhvillohen në bazë grupi me 10 studentë. Realizimi dhe dorëzimi i relacionit për punët e laboratorit bëhet gjatë procesit të zhvillimit të tyre dhe përfundon në javën e 12-të. Laboratorët janë parakusht për lejimin në provim.</i>		

Praktika:	0 kreditex 23 orë	0 orë
<i>Shënime mbi zhvillimin e praktikave...</i>		

Detyrëkursi:	0 kreditex 5 orë	0 orë
<i>Detyra e kursit jepet në javën e 5-të deri në javën e 8-të të semestrit të parë, të vitit të dytë. Detyra e kursit është individuale për çdo student. Dorëzimi i detyrës bëhet në javën e 11-të deri në javën e 14-të. Detyra e kursit është parakusht për lejimin në provim.</i>		

Kontrolletgjatë semestrit tëzhvillimit tëlëndës	2 orë
<i>Lënda kontrollohet me dykolegijume meshkrimgjatësemestrit të parë, të vitit të dytë. Kontrolli i parëzhvillohetnëjavën e6-të, osetë 7-të. Kontrolli i dytëzhvillohetnëjavën e 10- të, osetë 11-të.</i>	

Parakushte për hyrjen në provimin e lëndës



Lënda është e ndërvarur:

- frekuentimi i seminareve në masën 75 %;
- frekuentimi i laboratoreve në masën 100%;
- Frekuentimi i seminareve në masën 75 %; Zhvillimi dhe dorëzimi i relacioneve të laboratorëve.

Provimi i lëndës

3 orë

Lënda jepet provim me shkrim dhe me gojë në sesionin përkatës të provimeve. Teza e provimit me shkrim përmban vetëm ushtrime. Teza e provimit të teorisë përmban dy pyetje teorike. Raporti i provimit me shkrim me atë me gojë është 30% me shkrim dhe 60% me gojë

Vlerësimi përlëndën

Lënda vlerësohet në bazë të rezultatit të provimit me gojë, me shkrim dhe 10% të vlerësimit të ka aktivizimi në seminare dhe laboratorët

Literatura bazë për lëndën

Bardhi A.	<i>Leksione të shkruara</i>	2018
Vass, P	<i>The Space Vector Method for Induction Machine</i>	1991
KundurP.,	<i>Power System Stability and Control</i>	McGraw-Hill, 1994 ISBN – 13: 978-0-07-035958-1

Literatura e rekomanduar për lëndën

Vass, P.	<i>Parameter Estimation, Condition Monitoring, and Diagnosis of Electrical Machines</i>	Oxford University Press, 1993. ISBN 0-19-859375-9

Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës

Hapësira ku pedagogu parashtron mendime, rekomandime, vërejtje, kufizime, rezerva që lidhen me zhvillimin e lëndës në fjalë gjatë vitit akademik, nëse ka.



MAKINA ELEKTRIKE SPECIALE

Kodi i lëndës	Tipologjia e lëndës	Lloji i lëndës	Viti akademik	Semestri
	B	E detyrueshme	2018-2019	Sem. I

Departamenti i Automatikës	(firma e titullarit të lëndës)
Programi i studimit: Master Shkencor, Automatizim Industrie	
Titullari i lëndës: Dr. Alfred PJETRI alfredpjetri@gmail.com	
Pedagogë të Lëndës:	

Aktiviteti mësimor	Leksion	Seminar	Laborator	Praktikë	Detyra	Total
Kreditet (ECTS)	3	2	1	0	0	6
Orë në auditor	30	24	20	0	0	74
Orë jashtë auditorit	45	26	5	0	0	76
Orë gjithsej	75	50	25	0	0	150

Njohuri paraprake

Përpara zhvillimit të lëndës së Makinave Elektrike Speciale studenti duhet të ketë njohuri mbi makinat asinkrone, makinat sinkrone dhe makinat e rrymës së vazhduar. Gjithashtu studenti duhet të jetë i familjarizuar me ekuacionet diferenciale dhe me softin SIMULINK/MATLAB.

Objektivat e lëndës

Qëllimi kryesor i lëndës është të japë njohuri të përgjithshme mbi tipet më të përdorura të makinave elektrike speciale.

Njohuri mbi magnetët permanentë. Llojet e tyre, karakteristika e cmagnetizimit, pika e punës. Përmasimi i magnetëve permanentë, rrjeta Halbach, etj.

Njohuri mbi ndërtimin dhe parimin e punës të motorëve të rrymës alternative sic janë: motorët asinkronë njëfazorë, motorët njëfazor të rrymës alternative me kolektor, motorët e histerezit me magnet permanent, motorët sinkronë me magnet permanentë, motorët sinkronë reaktivë, motorët me pole të ekranuara, motorët e rrymës së vazhduar pa furca, etj. Karakteristikat mekanike të tyre, rregullimi i shpejtësisë, përdorimi, modelet matematike të disa prej tyre, etj.

Njohuri mbi ndërtimin dhe parimin e punës të motorëve të rrymës së vazhduar me magnet permanentë, motorëve me pole të dukshme në stator dhe rotor, etj. Karakteristikat mekanike të tyre, rregullimi i shpejtësisë, përdorimi, modelet matematikë, etj.

Njohuri mbi ndërtimin dhe parimin e punës së motorëve me hapa dhe motorëve asinkronë linearë. Llojet e tyre

Njohuritë dhe aftësitë që përfitohen nga përvetësimi i lëndës

Lënda zhvillohet në semestrin e parë, në vitin e parë, Master Shkencor, në 12 javë. Me fitimin e krediteve të saj studenti duhet të jetë i aftë:

- Të dijë ndërtimin dhe përdorimin e tipeve të ndryshme të makinave elektrike speciale.
- Të dijë parimet e punës dhe fenomenet kryesore që shoqërojnë regjimet e ndryshme të



punës të makinave elektrike speciale.

- Të përzgjedhë llojin e makinës dhe treguesit teknik në bazë të kushteve teknike të teknologjisë.

Konceptet themelore

Konceptet dhe termat bazë mbi të cilën ndërtohet lënda.

Koncept 1

Koncept 2 ...

Leksione:	3 kredite x 10 orë	30 orë
Motorët njëfazorë të rrymës alternative me kolektor. Ndërtimi dhe parimi i punës. Momenti elektromagnetik dhe karakterisitika mekanike. Mënyrat e rregullimit të shpejtësisë.		2.5 orë
Motorët asinkronë njëfazorë. Fusha magnetike pulsuese, skema e zëvendësimit dhe karakteristika mekanike e motorit asinkron njëfazor që ka vetëm një pështjellë në stator.		2.5 orë
Llojet e motorëve asinkronë njëfazorë. Karakteristikat mekanike të tyre. Skema e zëvendësimit e motorit asinkron një fazor kur ushqehen të dy pështjellat, ajo e punës dhe e lëshimit.		2.5 orë
Motorët sinkronë reaktivë trefazor dhe motorët me pole të ekranuara. Ndërtimi dhe parimi i punës. Momenti elektromagnetik dhe karakteristika mekanike. Rregullimi i shpejtësisë.		2.5 orë
Magnetet permanentë, llojet e tyre, karakteristika e cmagnetizimit. Densiteti i energjisë, energjia e rezervuar në magnet, vëllimi.		2.5 orë
Ndikimi i fushës magnetike të jashtme mbi magnetët permanentë. Përcaktimi analitik dhe grafik i pikës së punës. Format e ndryshme të realizimit të magnetëve permanentë. Llojet e magnetizimit dhe ideja e realizimit të rrjetës Halbach.		2.5 orë
Motorët sinkronë trefazorë me magnet permanentë. Njohuri të përgjithshme, modeli matematik në kordinata fazore. Vektori hapsinor, modeli matematik në kordinata ortogonale.		2.5 orë
Motorët e rrymës së vazhduar pa furca. Njohuri të përgjithshme. Modeli matematik, f.k.e.m trapezoidale. Karakteristika mekanike.		2.5 orë
Motorët e rrymës së vazhduar me magnetë përmanentë. Ndërtimi. Modeli matematik në regjim të vendosur. Karakteristika mekanike. Mënyrat e rregullimit të shpejtësisë.		2.5 orë
Motorët e Histerezit dhe motorët me pole të ekranuara. Ndërtimi dhe parimi i punës. Momenti elektromagnetik dhe karakterisitika mekanike.		2.5 orë



Motorët me pole të dukshme në stator dhe rotor dhe motorët me hapa. Ndërtimi parimi i punës dhe llojet e rreze.	2.5 orë
Transformatorët me tre pështjella dhe transformatorët e saldimit.	2.5 orë

Seminare:	2 kredite x 12 orë	24 orë
Motorët njëfazorë të rrymës alternative me kolektor.		2 orë
Skema e zëvendësimit dhe karakteristika mekanike e motorit asinkron njëfazor që ka vetëm një pështjellë në stator.		2 orë
Skema e zëvendësimit e motorit asinkron një fazor kur ushqehen të dy pështjellat, ajo e punës dhe e lëshimit.		2 orë
Motorët sinkronë reaktivë trefazor dhe motorët me pole të ekranuara.		2 orë
Densiteti i energjisë, energjia e rezervuar në magnet, vëllimi.		2 orë
Përcaktimi analitik dhe grafik i pikës së punës në magnetët permanentë.		2 orë
Motorët sinkronë trefazorë me magnet permanentë.		2 orë
Karakteristika mekanike e motorit të rrymës së vazhduar pa furca.		2 orë
Mënyrat e rregullimit të shpejtësisë të motorëve të rrymës së vazhduar me magnet përmanentë.		2 orë
Motorët e Histerezit.		2 orë
Motorët me pole të dukshme në stator dhe rotor.		2 orë
Motorët me hapa.		2 orë
Transformatorët trefazor me dy pështjella		2 orë
Transformatorët e saldimit		2 orë

Laboratore:	1 kredite x 20orë	20 orë
Studimi eksperimental i motorit njëfazor të rrymës alternative me kolektor		5 orë
Studimi eksperimental i motorit asinkron njëfazor.		5 orë
Studimi eksperimental i motorit sinkron reaktiv trefazor.		5 orë
Realizimi dhe simulimi i modelit të motorit sinkron trefazor me magnet permanent.		5 orë

Puna e laboratorit të motorit njëfazor të rrymës alternative me kolektor zhvillohet në javën e 3 dhe 4. Puna e laboratorit të motorit asinkron njëfazor zhvillohet në javën e 5 dhe 6. Puna e laboratorit të motorit sinkron



reaktiv trefazor zhvillohet në javën e 7 dhe 8. Puna e laboratorit të motorit sinkron trefazor me magnet permanent zhvillohet në javën e 9 dhe 10. Parakusht për hyrjen në provim është zhvillimi dhe dorëzimi i relacioneve të laboratorëve. Punët e laboratorit zhvillohen në bazë grupi me 10 studentë. Në çdo post pune marrin pjesë 5 studentë.

Praktika:	0 kreditex 23 orë	0 orë
Tema 1		0 orë
Tema 2		0 orë
Tema 3		0 orë
<i>Shënime mbi zhvillimin e praktikave...</i>		

Detyrëkursi:	0 kredite x 5 orë	0 orë
		0 orë
		0 orë

Kontrollet gjatë semestrit të zhvillimit të lëndës	2.5 orë
<i>Lënda kontrollohet me kolegium me shkrim gjatë semestrit të parë të vitit të parë. Kontrolli zhvillohet në javën e 7 të semestrit të dytë.</i>	

Parakushte përhyrjennë provimin e lëndës
Lënda është e ndërvarur: <ul style="list-style-type: none">• frekuentimi i seminareve në masën 75 %;• frekuentimi i leksioneve në masën 75 %;• frekuentimi i laboratoreve në masën 100%;• dorëzimi i relacioneve të laboratorëve në masën 100 %

Provimi i lëndës	4 orë
<i>Lënda jepet provim me shkrim në sesionin përkatës të provimeve. Teza e provimit me shkrim përmban 4 pyetje. Tre pyetje janë teorike dhe një pyetje është ushtrim. Teoria ka 60%, ushtrimi ka 30%.</i>	

Vlerësimi për lëndën
<i>Lënda vlerësohet në bazë të rezultatit të provimit me shkrim dhe 10% të vlerësimit e ka aktivizimi në seminare dhe laboratore.</i>



Literatura bazë për lëndën

Pjetri A	<i>Leksione të shkruara</i>	2016
----------	-----------------------------	------

Literatura e rekomanduar për lëndën

Venkataratnam K	<i>Special Electric Machines</i>	CRC Press, 2009.
Bhag S. Guru, Huseyin R. HizirogluKingsley	<i>Electric Machinery and Transformers</i>	Oxford University Press, 2000
Fitzgerald A, Kingsley C.	<i>Electrical Machinery</i>	McGraw, 2002
Charles I. Hubert	<i>Electric Machines</i>	Pearson Education Inc, 2002

Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës

Hapësira ku pedagogu parashtron mendime, rekomandime, vërejtje, kufizime, rezerva që lidhen me zhvillimin e lëndës në fjalë gjatë vitit akademik, nëse ka.



PLOTËSIMI NË ELEKTRONIKËN E FUQISË (SHNDËRUESIT STATIKË II)

Kodi i lëndës	Tipologjia e lëndës	Lloji i lëndës	Viti akademik	Semestri
	B	E detyrueshme	2018-2019	Sem. I

Departamenti i Automatikës	(firma e titullarit të lëndës)
Programi i studimit: Master i Shkencave në Automatizim Industrie	
Titullari i lëndës: Thomaq Koblara, Doktor, tomikoblara@gmail.com	
Pedagogë të Lëndës: Thomaq Koblara, Doktor, tomikoblara@gmail.com	

Aktiviteti mësimor	Leksion	Seminar	Laborator	Praktikë	Detyra	Total
Kreditet (ECTS)	3	2	0.5	-	0.5	6
Orë në auditor	30	24	10	-	10	74
Orë jashtë auditorit	45	26	15	-	10	96
Orë gjithsej	75	50	25	-	20	170

Njohuri paraprake

Studenti duhet të ketë fituar njohuritë bazë mbi sinjalet dhe format kryesore të tyre, bazat e elektronikës, bazat e makinave elektrike dhe transmiseve elektrike si dhe elektronikën numerike. Gjithashtu studentin duhet të ketë fituar njohuritë bazë mbi elektronikën e fuqisë pjesë e konvertuesve statikë gjatë ciklit të parë të studimeve (bachelor)

Objektivat e lëndës

Konvertorët statikë janë një pjesë e rëndësishme e elektronikës së fuqisë. Ata realizojnë lidhjen elektrike dhe elektronike midis sistemeve të fuqisë (makinat elektrike, sisteme ndriçimi, furra elektrike, etj) dhe sistemeve të kontrollit automatik (rregullatorëve industrialë).

Gjatë zhvillimit të lëndës studentin përforcon njohuritë në lidhje me klasifikimin ndërtimin dhe projektimin e konvertorëve statikë. Studentin njihet me skemat e mbrojtjes së elementëve elektronikë si dhe me metodat e dimensionimit të qarqeve mbrojtës. Programi mësimor i lëndës mësimore është i ndarë në katër pjesë.

- Në pjesën e parë studiohet klasifikimi dhe mbrojtja e elementëve të komanduar (transistorëve, tiristorëve dhe tiristorëve GTO) të elektronikës së fuqisë.
- Në pjesën e dytë studiohen konvertorët statikë të cilët modifikojnë parametrat e rrymës (tensionit) së vazhduar.
- Në pjesën e tretë studiohen konvertorët statikë të cilët modifikojnë parametrat e rrymës (tensionit) alternative.
- Në pjesën e katërt studiohen konvertorët statikë të cilët konvertojnë rrymën (tensionin) e vazhduar në rrymë (tension) alternativ.

Njohuritë dhe aftësitë që përfitohen nga përvetësimi i lëndës

Lënda zhvillohet në semestrin e parë, në vitin e parë të ciklit master profesional në sistemet mekatronike, në 12 javë. Me fitimin e krediteve të saj studentin duhet të jetë aftë:

- Të njohë elementët elektronikë dhe qarqet e mbrojtjes.
- Të njohë skemat konstruktive si dhe mënyrën e funksionimit të konvertorëve statikë të cilët modifikojnë parametrat e rrymës (tensionit) së vazhduar.
- Të njohë skemat konstruktive si dhe mënyrën e funksionimit të konvertorëve statikë



parametrat e rrymës (tensionit) alternative.

- Të njohë skemat konstruktive si dhe mënyrën e funksionimit të konvertorëve statikë të cilët konvertojnë rrymën (tensionin) e vazhduar në rrymë (tension) alternativ

Konceptet themelore

Konceptet themelore mbi të cilat është bazuar lënda janë si më poshtë:

- Konvertorët statikë.
- Skemat e qarkut të fuqisë së konvertorit statik.
- Modifikimi i karakteristikës së valës së tensionit dhe rrymës.
- Skemat e komandë dhe kontrollit të elementëve elektronikë.
- Mbrojtja e elementëve elektronikë.
- Metodot bazë në për llogaritjen e projektimit të qarkut të fuqisë së konvertorit statik.
- Roli i konvertorit statik në transmisionet elektrike dhe sistemet robotike

Leksione:	3 kredite x 10 orë	30 orë
Hyrje në Elektronikën e Fuqisë. Nocione të përgjithshme. Elementet e elektronikës se fuqisë, Dioda, tiristorët dhe transistorët e fuqisë. (simbolet zonat e punës dhe klasifikimi i përgjithshëm i tyre)		1 orë
Konvertorët Statikë – Klasifikimi i tyre. Karakteristika të përgjithshme. Procesi i komutimit. Klasifikimi i konvertorëve statike në funksion të procesit të komutimit.		1 orë
Qarqet e mbrojtjes së diodës së fuqisë. Klasifikimi dhe mënyra e funksionimit. Përcaktimi i parametrave të elementëve mbrojtës.		1 orë
Qarqet e mbrojtjes së tiristorit SCR të fuqisë. Klasifikimi dhe mënyra e funksionimit. Përcaktimi i parametrave të elementëve mbrojtës.		1 orë
Qarqet e mbrojtjes së transistorëve të fuqisë. Qarku i mbrojtjes së transistorit bipolar, MOS-FET dhe IGBT. Klasifikimi dhe mënyra e funksionimit. Përcaktimi i parametrave të elementëve mbrojtës.		1 orë
Qarqet e mbrojtjes së tiristorëve plotësisht të komanduar të fuqisë. Klasifikimi dhe mënyra e funksionimit. Përcaktimi i parametrave të elementëve mbrojtës.		1 orë
Konvertorët statikë të cilët modifikojnë parametrat e rrymës (tensionit) së vazhduar. Klasifikimi i tyre në funksion të procesit të komutimit		1 orë
Konvertorët zbritës të tensionit (Buck ose step-down). Skema elektronike e konvertorit si dhe funksionimi i tij. Regjimet e punës. Projektimi i qarkut të fuqisë së konvertorit.		1 orë
Konvertori Forward. Skema elektronike e konvertorit si dhe funksionimi i tij.		1 orë
Konvertorët rritës të tensionit (Boost ose step-up). Skema elektronike e konvertorit si dhe funksionimi i tij. Regjimet e punës. Projektimi i qarkut të fuqisë.		2 orë
Konvertorët rritës zbritës të tensionit (Buck-Boost ose step-down, step-up). Skema elektronike e konvertorit si dhe funksionimi i tij. Regjimet e punës. Projektimi i qarkut të fuqisë.		1 orë
Konvertori Fly-back. Skema elektronike e konvertorit si dhe funksionimi i tij.		1 orë
Konvertori CUK. Skema elektronike e konvertorit si dhe funksionimi i tij.		1 orë
Konvertori SEPIC. Skema elektronike e qarkut të fuqisë. Funksionimi i tij. Regjimet e punës.		1 orë
Konvertorët e rrymës së vazhduar me regjim pune në dy dhe katër kuadrate. Skemat e bazë. Regjimet e punës. Elemente bazë të projektimit. Konvertorët gjysmë urë dhe urë e plotë.		1 orë



Konvertorët e rrymës së vazhduar me qark rezonant. Qarku rezonant seri dhe paralel. Konvertori zbritës i tensionit me qark rezonant. Etapat e punës. Qarku ekuivalent i konvertorit si dhe format e valëve.	2 orë
Konvertorët e rrymës së vazhduar me qark rezonant seri. Etapat e punës në funksion të frekuencës së rezonancës. Format e valëve. Qarku ekuivalent	1 orë
Konvertorët e rrymës së vazhduar me qark rezonant paralel. Etapat e punës në funksion të frekuencës së rezonancës. Format e valëve. Qarku ekuivalent.	1 orë
Çelësat e tensionit alternativ. Çelësat monofazë dhe trefazorë. Skemat si dhe regjimi i punës.	1 orë
Variatorët e tensionit alternativ. Variatorët monofazë dhe trefazorë. Skemat si dhe regjimi i punës.	1 orë
Ciklokonvertoret monofazë dhe trefazorë. Skemat konstruktive, format e valëve. Mënyra e komandimit të elementëve elektronikë	1 orë
Konvertorët statikë të cilët konvertojnë rrymën (tensionin) e vazhduar në rrymë (tension) alternativ (Invertorët) Klasifikimi i tyre. Skemat konstruktive të invertorëve monofazë.	2 orë
Gjenerimi i sinjalit PWM për invertorët monofazë. Komanda monopolare, bipolare. Kontrolli i harmonikave të nivelit të lartë. Modulatori Delta – Sigma.	1 orë
Klasifikimi i invertorëve në funksion të qarkut të ndërmjetëm. Skemat konstruktive të invertorëve trefazorë. Invertorët me tiristorë. Invertorët autonomë me tiristorë. Invertorët trefazorë me transistorë.	3 orë
Komanda PWM për invertorët trefazorë. Komandimi i elementëve elektronikë bazuar në skemat e kontrollit të makinave elektrike.	1 orë

Seminare:	2 kredite x 12 orë	24 orë
Skema e komandës së tiristorit SCR të fuqisë. Dimensionimi i qarkut të komandës së tiristorit të fuqisë		1 orë
Skema e komandës së transistorit bipolar të fuqisë. Dimensionimi i qarkut të komandës së transistorit.		1 orë
Skema e komandës së transistorit MOS-FET të fuqisë. Dimensionimi i qarkut të komandës së transistorit.		1 orë
Skema e komandës së transistorit IGBT të fuqisë. Dimensionimi i qarkut të komandës së transistorit.		1 orë
Dimensionimi i qarkut të mbrojtjes së tiristorit të fuqisë.		1 orë
Dimensionimi i qarkut të mbrojtjes së transistorit të fuqisë.		1 orë
Konvertori zbritës i tensionit me transistorë. Dimensionimi i qarkut të fuqisë. Llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës mesatare, llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës efektive në funksion të karakteristikave të ngarkesës në dalje. Ndërtimi i formës së valës së rrymës dhe tensionit në dalje të konvertorit.		1 orë
Konvertori zbritës i tensionit me tiristorë. Dimensionimi i qarkut të fuqisë. Llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës mesatare, llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës efektive në funksion të karakteristikave të ngarkesës në dalje. Ndërtimi i formës së valës së rrymës dhe tensionit në dalje të konvertorit.		1 orë
Choppers. Dimensionimi i qarkut të fuqisë. Llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës mesatare, llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës efektive në funksion të karakteristikave të ngarkesës në dalje. Kontrolli i shpejtësisë së makinës së rrymës së vazhduar.		2 orë
Konvertori rritës i tensionit. Dimensionimi i qarkut të fuqisë. Llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës mesatare, llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës efektive në		1 orë



funksion të karakteristikave të ngarkesës në dalje. Ndërtimi i formës së valës së rrymës dhe tensionit në dalje të konvertorit.	
Konvertori me qark rezonant seri. Llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës mesatare, llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës efektive në funksion të karakteristikave të ngarkesës në dalje. Ndërtimi i formës së valës së rrymës dhe tensionit	1 orë
Konvertori me qark rezonant paralel. Dimensionimi i qarkut të fuqisë. Llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës mesatare, llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës efektive në funksion të karakteristikave të ngarkesës në dalje. Ndërtimi i formës së valës së rrymës dhe tensionit	1 orë
Radriзаторët monofazë me tiristorë. Dimensionimi i qarkut të fuqisë. Llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës mesatare, llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës efektive në funksion të karakteristikave të ngarkesës në dalje. Ndërtimi i formës së valës së rrymës dhe tensionit në dalje të konvertorit.	2 orë
Radriзаторët trefazorë me tiristorë. Dimensionimi i qarkut të fuqisë. Llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës mesatare, llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës efektive në funksion të karakteristikave të ngarkesës në dalje. Ndërtimi i formës së valës së rrymës dhe tensionit në dalje të konvertorit.	2 orë
Rregullatorët e tensionit alternativ. Realizimi i qarkut të komandës. Llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës mesatare, llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës efektive në funksion të karakteristikave të ngarkesës në dalje. Ndërtimi i formës së valës së rrymës dhe tensionit në dalje të konvertorit.	2 orë
Invertorët monofazë me transistorë. Dimensionimi i qarkut të fuqisë. Llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës mesatare, llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës efektive në funksion të karakteristikave të ngarkesës në dalje. Ndërtimi i formës së valës së rrymës dhe tensionit në dalje të konvertorit.	2 orë
Invertorët trefazorë me transistorë. Dimensionimi i qarkut të fuqisë. Llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës mesatare, llogaritja e vlerës së tensionit dhe rrymës efektive në funksion të karakteristikave të ngarkesës në dalje. Ndërtimi i formës së valës së rrymës dhe tensionit në dalje të konvertorit.	1 orë
Modulatori delta – sigma me amplifikatorë operacionalë. Sinjali PWM.	1 orë
Llogaritja e humbjeve tek konvertorët statikë. Humbjet termike. Dimensionimi i elementëve ftohës.	1 orë

Laboratore:	0.5 kredite x 20orë	10 orë
Hyrje ne Punet e Laboratorit		1 orë
Teknika e sigurimit teknik në sistemet e elektronikës se fuqisë		
Modelimi në Matlab/Simulink i radriзаторëve mono fazë.		1 orë
Modelimi në Matlab/Simulink i radriзаторëve trefazorë.		
Modelimi ne Matlab/Simulink i konvertorit zbritës, rritës si dhe rritës zbritës i tensionit		1 orë
Modelimi ne Matlab/Simulink i konvertorit flyback, dhe forward te tensionit.		1 orë
Modelimi ne Matlab/Simulink i konvertorit të rrymës së vazhduar me regjim pune në dy dhe katër kuadrantë.		1 orë



Modelimi ne Matlab/Simulink i qarkut rezonant	1 orë
Modelimi ne Matlab/Simulink i konvertorit me qark rezonant seri dhe paralel te tensionit.	1 orë
Modelimi ne Matlab/Simulink i formës së valës tek invertori monofazë gjysmë urrë dhe urrë e plotë	1 orë
Modelimi ne Matlab/Simulink i formës së valës tek invertori trefazor gjysmë urrë dhe urrë e plotë	1 orë
Modelimi ne Matlab/Simulink i komandes PWM. Projektimi i qarkut me ndihmën e programit Pspice, Modulatori Delta-Sigma	1 orë
<p><i>Punët e laboratorit zhvillohen në javën e 5-të deri në javën e 12-të të semestrit të parë, të vitit të dytë. Punët e laboratorit zhvillohen në bazë grupi me 10 studentë. Në çdo post pune marrin pjesë 2 deri 3 studentë. Realizimi dhe dorëzimi i relacionit për punët e laboratorit bëhet në javën e 13-të deri në javën e 14-të. Labororet janë parakusht për lejimin në provim.</i></p>	

Praktika:	0 kredite x 23 orë	0 orë

Detyrë kursi:	0.5 kredite x 20 orë	10 orë
Projektimi dhe studimi i qarkut rezonant. Karakteristika statike dhe dinamike		1 orë
Projektimi dhe studimi i konvertorit të rrymës së vazhduar me qark rezonant seri. Karakteristika statike dhe dinamike		2 orë
Projektimi dhe studimi konvertorit të rrymës së vazhduar me qark rezonant paralel. Karakteristika statike dhe dinamike		2 orë
Referat për konvertorët statikë të tipit Forward		1 orë
Referat për konvertorët statikë të tipit Flyback		1 orë
Referat për konvertorët statikë të tipit Push – Pull		1 orë
Referat për konvertorët statikë të tipit SEPIC		1 orë
Referat për konvertorët statikë të tipit Dual SEPIC		1 orë
<p><i>Detyra e kursit jepet në javën e 7-të deri në javën e 10-të të semestrit të parë. Detyra e kursit është individuale për çdo student. Dorëzimi i detyrës bëhet në javën e 11-të deri në javën e 12-të. Detyra e kursit është parakusht për lejimin në provim.</i></p>		

Kontrollet gjatë semestrit të zhvillimit të lëndës	2 orë
<p><i>Seminaret e lëndës kontrollohen me dy detyra kontrolli me shkrim gjatë semestrit të parë, të vitit të parë. Kontrolli i parë zhvillohet në javën e 6-të. Kontrolli i dytë zhvillohet në javën e 11-të.</i></p>	

Parakushte për hyrjen në provimin e lëndës
Lënda nuk është e ndërvarur.
Që studenti të pranohet në provim duhet të plotësojë kushtet si më poshtë:



- Frekuentimi i seminareve në masën 75 %
- Dorëzimi i dhe verifikimi i detyrës së kursit.

Provimi i lëndës

2.5 orë

Lënda jepet provim me shkrim, në sesionin përkatës të provimeve. Teza e provimit përmban 50% pyetje teorike, nga tematika e leksioneve dhe 50 % ushtrime, nga tematika e seminareve dhe shembuj te trajtuar në leksionet.

Vlerësimi përlëndën

Lënda vlerësohet 80 % sipas provimit përfundimtar dhe 20 % sipas rezultateve të kontrolleve dhe detyrës.

Literatura bazë për lëndën

M. H. Rashid	Power Electronics, 2nd ed.,	Prentice-Hall, Englewood Cliffs, NJ, 2007. ISBN 0-12-581650-2
M. H. Rashid	Power Electronics Handbook	PrenticeHall, Englewood Cliffs, NJ, 2011 ISBN 978-0-12-382036-5
N. Mohan, T. M. Undeland, and W. P. Robbins,	Power Electronics: Converters, Applications and Design, 2nd ed.,	John Wiley & Sons, New York, 1995. ISBN 0-471-58408-8
R. Erickson	Fundamentals of Power Electronics	Chapman and Hall, New York, 1997 ISBN 0-7923-7270-0
<i>Denis Fewson</i>	Introduction to Power Electronics	Oxford University Press, Inc., New York 1998 ISBN 0-340-69143-3
MARIAN K. KAZIMIERCZUK	Pulse-width Modulated DC–DC Power Converters	John Wiley & Sons, Ltd 2008 ISBN 978-0-470-77301-7

Literatura e rekomanduar për lëndën

N. Mohan, T. M. Undeland, and W. P. Robbins,	Power Electronics: Converters, Applications and Design, 2nd ed.,	John Wiley & Sons, New York, 1995. ISBN 0-471-58408-8
--	--	--



MARIAN K.
KAZIMIERCZUK

Pulse-width Modulated DC–DC Power Converters

John Wiley & Sons, Ltd
2008

ISBN 978-0-470-77301-7

Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës

Hapësira ku pedagogu parashtron mendime, rekomandime, vërejtje, kufizime, rezerva që lidhen me zhvillimin e lëndës në fjalë gjatë vitit akademik, nëse ka.



Aplikime Elektrike

Kodi i lëndës	Tipologjia e lëndës	Lloji i lëndës	Viti akademik	Semestri
xxxx	C	E detyrueshme	2018-2019	Sem. I

Departamenti i Automatikës	(firma e titullarit të lëndës)
